



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj Frëngjisht C 2

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë seminare
Semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda synon që studenti :Të përvetësojë njohuri të elementeve gjuhësore të frëngjishtes në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar specifikat fonetike; Të zhvillojë aftësi të analizës, si dhe shumë strategji të të nxënit që do të çojnë gradualisht drejt autonomisë gjuhësore; Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat për t’u prezantuar, për të folur për veprimtaritë dhe zakonet në jetën realeTë përvetësojë një metodë pune të pavarur. Të kalojë nga situata e të kuptuarit drejt të shprehurit. Të përvetësojë kompetenca të të kuptuarit, të lexuarit, të shprehurit me shkrim dhe me gojë.

Objektivat e specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

- Të njohë kompetencat gjuhësore bazë në situata të thjeshta, që lidhen me ambjentin rrethues.
- Të mund të zgjedhë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje për t’u prezantuar, për të prezantuar, për të përshkruar situata jetësore të tij : ndjenjat, emocionet, përjetimet e ndryshme në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen.
- Të përvetësojë kompetencat gjuhësore në rrethana të thjeshta.
- Të kuptojë kuptimin base të lajmërimeve dhe mesazheve të thjeshta e të qarta.